



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER

14 SHKURT 2008, Nr.31

Intervistë me Kryetarin e ri të Kuvendit të Kosovës



Editorial



Zgjedhjet parlamentare më 17 nëntor 2007 në masë të madhe kanë ndryshuar skenën politike në Kosovë. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) u bë partia më e madhe politike në Kosovë, e ndjekur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Parti të reja politike hynë në Kuvend, siç janë Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia Serbe Liberale (SLS). Pas disa javëve negociatash, PDK-ja dhe LDK-ja nënshkruan marrëveshjen e koalicionit për themelimin e qeverisë së re me mandat katër vjeçar.

Gjatë seancës inauguruese të Kuvendit të ri në fillim të janarit 2008, Deputetët u betuan, rizgjedhën Prof. Fatmir Sejdiun si President të Kosovës për periudhë 5 vjeçare, zgjedhën z. Hashim Thaçin për Kryeministër të qeverisë së koalicionit PDK-LDK me ministra tërësisht të ri. Dy ministrat serbë të SLS-së iu bashkuan kabinetit, bashkë me ministrin turk. Partitë në opozitë tani janë AKR, LDD, AAK dhe disa parti të vogla të pakicave. Kuvendi, po ashtu, miratoi Kryesinë e Kuvendit nën udhëheqjen e z. Jakup Krasniqit, Kryetarit të ri të Kuvendit.

Në takimin e parë, Kryesia e Kuvendit vendosi të krijojë 13 Komisione parlamentare, përfshirë një Komision të ri për të drejta të njeriut, një Komision të ri për integrim evropian dhe një Komision të ri për Rregulloren e punës, mandatet dhe imunitetet. Të gjithë Komisionet, përveç njërit, janë formuar. Ata tani janë dhe funksionojnë They are now up and running and ready to review the first laws to be tabled by the new government.

Following the November 2007 elections and thanks to the open-list electoral system, the new Assembly starts in a unique composition with more than half of its members new to parliament. Therefore, the OSCE Mission in Kosovo, the National Democratic Institute and USAID jointly prepared a five-day induction program for the new members of the Assembly. The induction program took place at the end of January and early February 2008, under the auspices of the President of the Assembly.

The 31st edition of the ASI Newsletter reflects upon the challenges of the third mandate of the Assembly of Kosovo and includes Assembly members' contributions based upon the discussions during the induction program. The President of the Assembly gave an exclusive interview for the ASI Newsletter.

In addition, this publication focuses on the assistance programs to the Assembly. The National Democratic Institute (NDI) is introducing its new legislative director, which we warmly welcome to Kosovo. The EU-project in the Assembly, being implemented by the Consortium of the parliaments of France, Germany, Belgium and Slovenia, has concluded its assistance program to the Assembly and its team leader gives his concluding remarks. The OSCE Mission in Kosovo elaborates on some aspects of its assistance to the Assembly. We hope that you find all the contributions in the publication interesting to consider.

We wish all parliamentarians of the third mandate good luck in performing their duties and responsibilities in the Assembly of Kosovo.

Franklin De Vrieze,
Assembly Support Initiative Co-ordinator.
14 Shkurt 2008

Editoriali	2
Kuvendi si institucion i debatit dhe i diskutimit të hapur	3
Institucionet e reja të Kosovës synojnë Kosovën, të jetë shtëpi dhe të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë	5
Institucionet e reja të Kosovës duhet të bëjnë shqyrtimin e përgjithshëm të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008	5
Thelbi i programit është mbijetesja jonë në Kosovë	6
Puna në komisione kërkon përkushtim profesional	8
Barazia gjinore është e domosdoshme në një vend demokratik	9
Përvoja ime si deputet i Kuvendit	10
Avancimi i mbikëqyrjes së ligjeve dhe i shpenzimeve qeveritare	11
Përkrahja administrative për deputetët e Kuvendit	12
Programi hyrës për deputetët e rinj të Kuvendit të Kosovës	13
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës t'i raportojë Kuvendit	14
Përfundimi i projektit të financuar nga BE-ja "Përkrahja e Mëtejme për Kuvendin e Kosovës"	15
Mirëseardhje për Ian Perkins, Drejtor Legjislativ i NDI	16
Përkrahja e punës së Kuvendit të Kosovës	16
Shoqëria civile dhe procesi legjislativ në Kosovë	18
Komisionet parlamentare në Kuvendin e Kosovës	19



Kuvendi si institucion i debatit dhe diskutimit të hapur

Intervistë me Kryetarin e ri të Kuvendit të Kosovës, Z. Jakup Krasniqi



ASI: Z. Kryetar, cilat janë prioritetet kryesore që i keni identifikuar për mandatin e tretë të Kuvendit të Kosovës? Çfarë ndryshimesh do të prezantoni gjatë këtij mandati?

Z. Jakup Krasniqi: Legjislatura e tretë e Kuvendit sapo ka filluar, duke pasur një agjendë të ngjeshur që e dikton situata historike nëpër të cilën po kalon Kosova. Ditët e shkuara patëm procesin e konsolidimit të strukturave të Kuvendit, si kompletimi i Kryesisë dhe funksionimi normal i saj, i kabinetit tim, i grupeve dhe komisioneve parlamentare etj. Krahas këtyre aktiviteteve të zakonshme në fillim të mandatit të ri, ne jemi në përgatitje intensive për shpalljen e pavarësisë dhe të njohjes ndërkombëtare të saj. Tashmë e kemi përmbyllur punën e hartimit të kushtetutës dhe jemi në përfundim të zgjedhjes së simboleve shtetërore të Kosovës. Këto pak ditë të punës sime si kryetar i Kuvendit, kam pritur dhjetëra delegacione ta jashtme e të brendshme, me të cilat në qendër të agjendës kishim shpalljen e pavarësisë dhe gjithë kushtet e rrethanat që duhet pasur

parasysh në përgatitje të këtij akti historik të Kosovës.

Do të përpiqemi që sa më shpejt të përfundojmë edhe planin e punës dhe kalendarin parlamentar për këtë vit.

Këtë vit Kuvendi në prioritet të lartë ka aprovimin e ligjeve që dalin nga Marrëveshja gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të propozuar nga zoti Ahtisaari, por edhe të ligjeve tjera të ngutshme që rregullojnë sfera të caktuara të jetës. Kalendarin e procedimit të projektligjeve gjatë këtij viti dhe në vitet vijuese do të jetë i ngarkuar, sepse ende ka shumë për t'u bërë në kompletimin e infrastrukturës ligjore në Kosovë. Ky kalendar varet shumë nga mundësitë e Qeverisë për të draftuar projektligjet.

Kuvendi do të jetë institucioni i debatit e diskutimeve të hapura, por edhe i promovimit të demokracisë parlamentare, i tolerancës dhe i kohezionit të shoqërisë së Kosovës.

Në vijim do të ndërmarrim gjithë veprimet

e nevojshme që Kuvendi ynë të jetë i hapur edhe ndaj qytetarëve, jo vetëm në kuptimin e ofrimit të informacionit të gjerë dhe të transparencës së plotë për qytetarët, por edhe të involvimit të tyre, nëpërmjet të debateve publike në vendimet e rëndësishme që do të nxirren prej tij.

Një angazhim tjetër i Kuvendit këtë vit do të jetë aprovimi i deklaratës së mijëvjeçarit të OKB-së dhe identifikimi i objektivave të Kosovës për të.

Kuvendi do të përgatisë dhe aprovojë edhe strategjinë e veprimit të tij në gjithë mandatin e legjislaturës në vijim.

ASI: Si do të mund të përforcohej roli i komisioneve parlamentare në mënyrë që shqyrtimi i ligjeve të bëhet në mënyrë më efektive dhe eficientë? A vazhdoni të jeni në favor të krijimit të një komisioni hetues, ide kjo të cilën e keni promovuar në të kaluarën?

Z. Jakup Krasniqi: Në këtë legjislaturë janë bërë disa ndryshime në strukturën e komisioneve parlamentare (nga 10

në 13), duke pasur parasysh pikërisht funksionalizimin më të mirë të tyre dhe efikasitetin në punë. Konsideroj që përgatitja profesionale e deputetëve në komisionet përkatëse, do t'i bëjë rrjedhimisht më eficiente ato. Kuvendi do të ketë më shpesh sesione, prandaj edhe komisionet do të kenë më shumë punë, pra edhe më shumë takime. Po konsideroj që edhe rezultatet do të jenë në proporcion me ritmin e angazhimeve dhe të mbledhjeve.

Puna e secilit anëtar dhe organ të kuvendit do të jetë e hapur dhe do t'i nënshtrohet vëzhgimit e kontrollit të votuesve. E drejta demokratike e votuesve fillon me votën e lirë, por nuk përfundon aty, sepse ata duhet të kontrollojnë punën dhe veprimtarinë e të zgjedhurve të tyre, duke mbajtur edhe të drejtën e revokimit në qoftë se zhgënjehen me besimin e dhënë. Gjithçka që kam thënë në këtë kuptim, është parimore dhe nuk kam asnjë arsye ta ndryshoj.

Kuvendi do t'i ushtrojë besnikërisht dhe në plotësi funksionet kushtetuese dhe procedurat e Rregullores së punës. Në draftkushtetutën e Kosovës është paraparë që me kërkesën e 30 deputetëve mund të formohet Komisioni Parlamentar Hetimor. Kjo iniciativë ka qenë imja në Komisionin Kushtetues.

ASI: Çfarë planesh ka Kuvendi i Kosovës në rritjen e bashkëpunimit me parlamentet e tjera jashtë?

Z. Jakup Krasniqi: Me zgjidhjen e statusit të Kosovës, Kuvendi i saj po hyn në një fazë të re të funksionit të tij, si organi më i lartë shtetëror legjislativ. Ne do të fillojmë dhe intensifikojmë komunikimet dhe marrëdhëniet e një formati tjetër me vendet tjera, në radhë të parë në fqinjësi të Kosovës, por edhe me SHBA, vendet anëtare të BE etj., me të cilat dëshirojmë bashkëpunim të sigurtë, në dobi të paqes dhe të interesave të ndërsjella.

ASI: Në të kaluarën keni thënë se ministrat nuk duhet të gëzojnë edhe postin e deputetëve të Kuvendit, duke u deklaruar kështu kundër mandatit të dyfishtë. Cila është pozita juaj tani?

Z. Jakup Krasniqi: Kam qenë dhe mbetem në pikëpamjen që funksioni i secilit nga kuadrot të jetë sa më i plotë dhe kjo arrihet duke u përkushtuar në përgjegjësitë specifike që ka, pa u shpërndarë energjitë dhe pa dëmtuar rezultatet e pritura në punën e besuar. Ekziston një bindje e përhapur te ne,



sikur detyra e deputetit fillon dhe mbaron në seancat parlamentare, por duhet ditur që angazhimi i deputetit do të jetë shumë më i dendur se kaq dhe ky angazhim do të bëhet i njohur në kuadër të hapjes së Kuvendit ndaj qytetarëve, që votuesit të mund të përcjellin dhe vlerësojnë punën e deputetëve të zgjedhur prej tyre. Vetë volumi i punëve që kërkohet nga deputeti, do ta bëjë të vështirë, ose edhe të pamundur angazhimin e tij paralel në funksione të tjera. Edhe kjo çështje është precizuar mirë në draftkushtetutën që pritet së shpejti të miratohet në Kuvendin e Kosovës.

ASI: Cili është mendimi juaj mbi reformat e propozuara të Sekretariatit? Çfarë ndryshimesh të tjera mendoni se janë të nevojshme aty?

Z. Jakup Krasniqi: Mendimëne donatorëve zemërgjerë, shumë projekte janë zbatuar në mbështetje të Kuvendit të Kosovës, si administratës, komisioneve parlamentare, deputetëve etj. Administrata e Kuvendit tashmë ka një nivel të lakmueshëm të përgatitjes profesionale. Administrata në pajtim me pakon e reformave të aprovuara nga Kryesia e Kuvendit në prill të vitit 2007, është e përkushtuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi që dalin prej saj. Tani për tani nuk do të specifikoja ndryshimet eventuale, por ndryshimet janë proces i vazhdueshëm, për të mbajtur ritmet e zhvillimit dhe azhurnimit të dijeve.

ASI: Një pyetje private, Z. Krasniqi: Sa ka ndryshuar dinamika e jetës suaj tani që jeni Kryetar i Kuvendit të Kosovës, nga ajo e deputetit dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së në mandatin e kaluar?

Z. Jakup Krasniqi: Natyrisht, dinamika e angazhimeve të tashme, ndryshon nga ajo që kisha në legjislaturën e kaluar edhe jashtë Kuvendit, tani kjo dinamikë është fokusuar esencialisht brenda Kuvendit të Kosovës. Përgjegjësia e kryetarit të Kuvendit, dhe në mënyrë të veçantë në Kosovën e kësaj faze historike është shumë e lartë dhe e mprehtë. Jam shumë i vetëdijshëm për rolin e pozitës sime, prandaj në përputhje me të, i kam përqendruar gjithë energjitë në përmbushjen e tij dhe për të merituar besimin që më është dhënë. Ky angazhim intensiv dhe ky ritëm i shtuar më privon më shumë nga jeta private dhe familjare.

Intervistoi: Armend Bekaj,
Misioni i OSBE-së në Kosovë

“Institucionet e reja të Kosovës synojnë një Kosovë, shtëpi dhe mundësi e barabartë për të gjithë”

Ekstrakt nga fjala e Presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu në seancën inauguruese plenare të Kuvendit të Kosovës në mandatin e tretë. (09 Janar 2008).



Më lejoni para së gjithash që t’ju shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim të thellë për besimin që më dhatë për të qenë edhe një mandat në krye të institucionit të Presidentit të vendit. Dua të zotohem para jush të nderuar deputetë dhe para qytetarëve të Kosovës se do të vihem me të gjitha fuqitë dhe dijen time në mbrojtjen dhe respektimin e ligshmërisë dhe kushtetutshmërisë. Kujdes të veçantë do t’i kushtoj ruajtjes së unitetit demokratik të vendit dhe me gjithë energjinë do të angazhohem për të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës [...]

Qytetarët e Kosovës dhe të gjitha partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur që garuan në këto zgjedhje, treguan pjekurinë e lartë politike duke e kapërcyer suksesshëm këtë sprovë të madhe dhe duke dëshmuar kulturë të lartë politike dhe shtetformuese.

Jam i bindur se institucionet e reja të Kosovës; Presidenca, Qeveria dhe Kuvendi fuqishëm dhe me energji të përbashkët do të japin kontributin maksimal të tyre në zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të demokracisë në Kosovë.

Po kështu, institucionet e Kosovës do të bashkëpunojnë ngushtë me praninë ndërkombëtare civile dhe ushtarake në periudhat tepër të rëndësishme dhe vendimtare në të cilat po hyn vendi ynë.

Në veçanti, institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që të mbrojnë dhe garantojnë liritë dhe të drejtat e të gjitha grupeve etnike joshumicë. Kujdes i veçantë do t’i kushtohet mirëqenies dhe integritetit plotë të komunitetit serb në Kosovë. Institucionet e reja të Kosovës synojnë një Kosovë, shtëpi dhe mundësi e barabartë për të gjithë.

“Qeveria e re e Kosovës do ta bëjë një rishikim të tërësishëm të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008”

Ekstrakt nga fjala e Kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi në seancën inauguruese plenare të Kuvendit të Kosovës në mandatin e tretë. (09 Janar 2008).



Më lejoni që në fillim t’i falënderoj të gjithë qytetarët e Kosovës për mbështetjen e dhënë, si dhe kryetarin e Kosovës për dhënien e mandatit për formimin e qeverisë, detyrë kjo që më kënaqësi e kam pranuar dhe me nder e përgjegjësi do ta ushtroj.

Të drejtat e minoritareve do të respektohen dhe garantohen përmes angazhimeve afirmative, të garantuara edhe me Kushtetutë.

Në javët vijuese, unë në emër të qeverisë së Kosovës do ta prezantoj para qytetarëve tërë projektin gjithëpërfshirës për Reforma Ekonomike.

[...] Qeveria e re e Kosovës do ta bëjë një rishikim të tërësishëm të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Projekti ynë shpalos pakon e detajuar për reformat në arsim, e cila do të sigurojë mundësi të reja për studentët tanë dhe do t’i sigurojë prindërit se fëmijët e tyre, fëmijët tanë do të kenë mundësi ta vënë në funksion potencialin e tyre intelektual.

Derisa vazhdojmë të ecim përpara së bashku, do t’u sigurojmë qytetarëve tanë sistem shëndetësor të nivelit të parë dhe të fillojmë krijimin e një sistemi në të cilin të gjithë qytetarët do të kenë sigurime shëndetësore, qoftë private apo publike.

Zotohemi sot, që qeveria jonë do t’i kushtojë kujdes të madh të moshuarve dhe do ta reformojë fondin pensional.

Të gjitha këto iniciativa do të jenë të pakuptimta në rast se nuk do të kemi qeveri të hapur dhe transparente.

Lufta kundër korrupsionit do të jetë e ashpër dhe me zero tolerancë ndaj kujtdo dhe kurdoherë.

Prandaj kërkoj mbështetjen tuaj, të institucioneve përgjegjëse vendore dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Thelbi i programit është mbijetesa jonë në Kosovë

Intervistë me z. Slobodan Petrović,
Krytar i Partisë Liberale Serbe (SLS)



ASI: Jeni zgjedhur anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues i komunitetit serb. Cilat do të jenë prioritetet e juaja në punën e përgjithshme të Kuvendit të Kosovës?

Slobodan Petrović: Sipas Kornizës Kushtetuese, komuniteti serb ka ulëse të garantuar në Kryesi. Ishte e rëndësishme të arrihet një marrëveshje brenda komunitetit serb lidhur me atë se kush do të bëhet pjesë e Kryesisë. Deputetët serb më propozuan mua dhe kandidatura gjithashtu u vërtetua në Kuvend, i cili më zgjodhi. Kjo vërtetë është shumë e rëndësishme për mua. Në anën tjetër, është një përgjegjësi e madhe, si për mua ashtu edhe për partinë të cilën e përfaqësoj dhe sigurisht për komunitetin tim.

Ajo që unë pres është padyshim një punë e vështirë. Të gjithë ne që jemi në Kuvend do të japim të gjithë kontributin tonë në mënyrë që të mbrojmë interesat e komunitetit serb, si dhe të komuniteteve tjera, jo me çmim të dëmtimit të çfarëdo komuniteti tjetër. Në këto kohëra të trazuara, ngjarjet na tejkalojnë, prandaj ne gjendemi në një lloj seance të vazhdueshme. Gjithashtu, pres që Kryesia do të ketë mirëkuptim për propozimet që do të vijnë nga unë lidhur me interesat e komunitetit serb. Nëse diçka është në interes të serbëve, kjo nuk do të thotë se është kundër komuniteteve tjera.

Sinqerisht shpresoj se do t'i justifikojë besimin dhe pritjet që ka komuniteti im. Unë gjithashtu jam i vetëdijshëm se unë nuk jam i gjithëfuqishëm dhe se nuk do të jem në gjendje të bëjë ndonjë lëvizje të madhe; megjithatë, e di se nga kjo pikë, do të jem në gjendje më të mirë t'i ndihmojë komunitetit tim. Nuk kam pritje të mëdha, kështu që më vonë do të kem më pak arsye për t'u ndier i zhgënjyer. Ka shumë faktorë që do të ndikojnë në punën e Kryesisë, si dhe në punën e të gjitha institucioneve të Kosovës. Ne i jemi bashkuar institucioneve dhe dëshirojmë që t'i kemi si instrument për mbrojtjen e interesave të komunitetit serb, të artikulohen çështjet e komunitetit serb dhe pres që ne do të arsyetojmë një përfshirje të tillë në institucione.

ASI: Partia Liberale Serbe ka dy ministri në kuadër të Qeverisë të Kosovës. Kjo është një përgjegjësi e madhe në kurriz të një partie kaq të re politike. Si ja dilni ballë ju me këtë? Çfarë dëshironi të arrini?

SP: Ju keni shumë të drejtë kur thoni se kjo është një përgjegjësi e madhe; për mua dhe për të gjithë njerëzit tjerë në kuadër të institucioneve, se pari njerëzve nga Partia Liberale Serbe, të cilët i kanë, jo vetëm familjet e tyre, por gjithashtu edhe një numër njerrëzish të cilët ua dhanë besimin gjatë zgjedhjeve. Sigurisht që është një ngakesë e madhe për të gjithë ne.

Ne si parti nuk kemi kërkuar të marrim të gjithë këtë përgjegjësi, nuk ishte kërkesë e jona. Megjithatë, ashtu si ndodhi, kjo ministria tjetër, që është menduar për komunitetin serb, na është kaluar neve gjithashtu. Ne jemi të vetëdijshëm që nuk do të veprojmë të vetëm në këto ministri. Ne gjithashtu u bëjmë ftesë të hapur të gjithë atyre që janë të motivuar për t'i ndihmuar komunitetit serb, pra me këtë edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës; po them se ata janë te mirëseardhur tek ne. Ne tani jemi në një periudhë shumë të vështirë, në pozita kaq të rëndësishme, por ne do të përpiqemi të japim maksimumin tonë për të arsyetuar pjesëmarrjen. Ne gjithashtu jemi të vetëdijshëm se ne nuk jemi të 'gjithëdijshëm' dhe i ftojmë të gjithë që kanë përvojë pune – ata janë të mirëseardhur dhe kjo nuk është një ftesë sa për të thënë, por e sinqertë.

Megjithatë, ne nuk frikohemi nga sfidat që na presin dhe do të bëjmë çdo gjë në mundësinë tonë që t'i kemi ministritë, për të cilat jemi përgjegjës, plotësisht funksionale. Është vërtetë një përgjegjësi e madhe për një parti relativisht të re që t'i ketë dy ministri në Qeveri, të ketë grupin e saj parlamentar me tetë anëtarë të Kuvendit. Është një sukses i madh për partinë tonë dhe, në anën tjetër, një përgjegjësi e madhe të cilën dëshirojmë ta ndajmë me të gjithë që kanë vullnet për një gjë të tillë.

Ne jemi në institucione sepse ne dëshirojmë të merremi me çështjet e jetës reale; sepse dëshirojmë një të nesërme më të mirë. Është më së lehti të heqësh dorë, të largohesh, gjithmonë mund ta bëni një gjë të tillë. Është shumë vështirë të jeni në këtë pozitë. Pajtohem se është një ngarkesë e madhe, barrë e madhe dhe shpresojë që, si institucionet kosovare ashtu edhe komuniteti ndërkombëtar do të kenë mirëkuptim për pozitën tonë dhe të na sigurojnë mbështetjen e tyre absolute.

ASI: A mbani ju dhe ministrat tuaj kontakte me qeverinë në Beograd?

SP: Fatkeqësisht jo. Megjithatë, unë shpresoj sinqerisht se ne do të krijojmë kontakte të tilla, meqë një nga tre faktorët më të rëndësishëm sot në Kosovë është pikërisht qeveria në Beograd dhe sa i përket komunitetit serb në Kosovë, është faktori më i rëndësishëm. Ne e pamë këtë gjatë zgjedhjeve. Ne nuk e kemi mbështetjen e plotë të të gjithë komunitetit serb në Kosovë për arsye të rekomandimeve të Beogradit për të mos marrë pjesë në zgjedhje. Është një çështje rënduese shtesë për ne, por shpresojë që edhe në Qeverinë e Serbisë do të ketë njerëz të cilët do të kenë kuptim për punën që e bëjmë ne, që është gjithashtu një interes thelbësor i Serbisë.

ASI: Cili është mendimi juaj për decentralizimin dhe krijimin e komunave të reja dhe si do ta trajtoni ju dhe ministrat e juaj këtë çështje?

SP: Decentralizimi është element shumë i rëndësishëm për mbijetesën e komunitetit serb në Kosovë dhe të gjithë palët e interesit duhet të marrin pjesë në këtë proces, të gjithë njerëzit e dijshtëm. Unë jam jurist, por e di se kjo është një çështje shumë komplekse dhe çështje shumë e rëndësishme për komunitetin serb. Sa i përket kësaj çështjeje, ne kemi rekrutuar disa profesorë të universitetit dhe pres që këtu do t'i arrijmë rezultatet më të mira. Ndonëse nuk do të varet vetëm prej nesh, njerëzit që do të marrin pjesë në këtë proces do të luajnë një rol të rëndësishëm. Decentralizimi është shumë i rëndësishëm për disa arsye. Është pa dyshim se krijimi i komunave të reja gjithashtu do të japë shpresa për ekzistencën e komunitetit serb në Kosovë. Veç kësaj, pjesëmarrja e njerëzve të cilët do të jenë kompetentë në ato komuna do të jetë e rëndësishme. Në këtë drejtim, emigrimi i permanent i popullatës serbe nga Kosova është problem i madh, përmes së cilës ndryshohet demografia në këto komuna të ardhshme. Kjo përbën çështjen

më serioze për komunitetin serb. Nëse keni, të themi, një komunë serbe, ku popullata serbe është pakicë, atëherë aty kjo nuk ka kuptim.

ASI: Shpejt pritet që Kuvendi i Kosovës do të shpallë pavarësinë. Cila është porosia juaj për popullatën serbe në Kosovë?

SP: Qëndrimi ynë ishte i qartë që nga dita e parë e krijimit të partisë, tash e dy vite më parë. Ne jemi të vetëdijshëm se ne i parti nuk do të ndikojmë në vendimin për statusin e ardhshëm të Kosovës. Që nga fillimi i negociatave, ne kemi mbështetur një zgjidhje kompromisi, që do të ishte më së miri. Ne gjithashtu kemi qenë shumë skeptik edhe gjatë asaj kohe, ndërsa tani është e qartë se një zgjidhje e tillë është gati e pamundur të arrihet. Tani kjo është një problem ndërkombëtarë dhe duhet të zgjidhet nga bashkësia ndërkombëtarë.

Çfarëdo qoftë rendimenti i bashkësisë ndërkombëtare, për ne është i pranueshëm. Nese e dëshirojnë disa apo jo, do të jetë detyruese. Kjo ditë është paralajmëruar shumë kohë më parë, ndonëse nuk e di se si do të jetë kjo, meqë nuk është në qëllimin e aktiviteteve tona – të deputetëve nga komuniteti serb. Ne jemi të vetëdijshëm për faktin se nuk mund të bëjmë asgjë lidhur me këtë. Nëse nuk ka përkrahje nga bashkësia ndërkombëtare, do të jetë e rrezikshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, qofshin ata nga komuniteti serb apo shqiptar. Çdo gjë që nuk ka përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare është e papranueshme dhe e papërshtatshme.

Është fakt që komuniteti serb është absolutisht kundër pavarësisë së Kosovës, ashtu siç dihet. I kundërt me këtë, komuniteti shqiptar është njëzëri për pavarësinë dhe prandaj është shumë e vështirë të gjendet diçka që mund të jetë e pranueshme për të dy palët. Prandaj, ne, deputetët nga komuniteti serb jemi në një situatë të palakueshme. Megjithatë, ne duhet të mendojmë për të ardhmen e popullit tonë dhe vendimet e interesit të përgjithshëm duhet të bëhen. Të merresh me politikë nuk do të thotë që gjithmonë të bëhen gjëra të mira, por gjithashtu edhe disa gjëra që ndonjëherë shumica nuk do të kuptonte. Megjithatë, shpresoj që shumë shpejt do të vijë dita kur e tërë kjo, që sot na preokupon ne dhe popullin e Kosovës, do të kalojë.

Esenca e programit tonë është mbijetesja

e komunitetit serb në Kosovë dhe nuk ka alternativë për këtë. Pas kësaj, situata e sigurisë është shumë e rëndësishme për ne. Gjithashtu siguria ekonomike e komunitetit serb është e rëndësishme për ne. Këto elemente janë shumë të rëndësishme për ne. Problemet e qytetarëve të Kosovës nuk do të zgjidhen me një deklaratë.

Në Kosovë, ne kemi shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë dhe ky është problemi më i madh. Qëllimi ynë është që të luftojmë për komunitetin tonë, në mënyrë demokratike, përmes institucioneve, ashtu siç garantohet sipas Kornizës Kushtetuese. Puna jonë është të angazhohemi në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë dhe bojkotimi dhe inatosja nuk do të japin rezultate. Ne shpresojmë për një hapësirë pa tensione, dhunë dhe diskriminim. Këto janë kërkesat për një jetë normale, në mënyrë që të mos ndjeheshim si qytetarë të rangut të dytë. Ka shumë për tu bërë, derisa shumë çështje nuk janë në kontrollin tonë, në disa siç janë marrëdhëniet e jetës së përditshme, kthimi, eksistenca, punësimi, strehimi dhe të ngjashme ne mund të ndikojmë.

Porosia për popullin tonë është që, çfarëdo që të ndodh, qytetarët duhet të jenë të qetë, ata nuk duhet të lejojnë që t'i mbizotërojnë paniku, dmth. Ata nuk duhet të bien pre e provokimeve, të cilat ka gjasë të ndodhin, dhe me këtë mendojë kryesisht në provokimet e shkallës së vogël. Më e keqja që ata mund të bëjnë është, ta braktisin Kosovën, meqë pastaj është shumë vështirë të kthehen. Ne sigurojmë do të jemi pjesë e komunitetit tonë dhe do të ndajmë fatin e komunitetit tonë. Unë jam shumë i bindur se nuk do të ketë dhunë meqë i kemi pranuar edhe garantitë e të gjithë përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare, psh. z, Rucker, përfaqësuesit e zyrave ndërkombëtare dhe udhëheqësit politik kosovarë.

Shpresoj që njerëzit të mbeten të qetë dhe të kthjellët dhe të përmbajtur. Ne të gjithë do të jemi këtu dhe do të ndajmë të njëjtin fat. Përsëri them, kurrë nuk është vonë për t'u larguar, këtë mund ta bëjmë kur të dëshirojmë, por është vështirë të kthehesh pastaj. Le ta presim të nesërmen, mëngjesi është gjithmonë më i urtë se mbrëmja.

Intervista nga Mario Maglov, Koordinator i Qendrave për Informim të Komuniteteve DPI-UNMIK në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë

Puna në komisione kërkon përqendrim profesional

Intervistë me Z. Bahri Hyseni – deputet i zgjedhur i Kuvendit të Kosovës dhe i emëruar si kryesues i Komisionit për Legjislacion dhe Çështje gjyqësore

ASI: Z. Hyseni, sa e rëndësishme është për ju të jeni Deputet i Kuvendit të Kosovës? Cilat do të jenë qëllimet e juaja gjatë mandatit?

Bahri Hyseni: Tani jemi në Legjislaturën e tretë, dhe padyshim kjo është përgjegjësi e dyfishtë për të gjithë ata të cilët kanë fituar mandatin e popullit. Po e njëjta gjë është edhe për mua. Tani askush nuk mund të thotë se nuk kemi përvojë parlamentare dhe, mandati është fituar drejtpërdrejt nga votuesi. Dhe kjo e ngrit përgjegjësinë si atë institucionale ashtu edhe përgjegjësinë para votuesve për besimin e dhënë.

Unë për veten time mund të deklaroj se do të jem në shërbim të institucionit (Kuvendit) dhe në shërbim të qytetarëve për të kryer me nder tri funksionet që i kemi si deputetë: të jemi përfaqësues të denjë të popullit, të mbikëqyrim punën e institucioneve vartëse të Kuvendit dhe dhënien e kontributit maksimal profesional në nxjerrjen dhe amendamentimin e ligjeve.

ASI: Ju jeni emëruar si Kryesues i Komisionit për Legjislacion. Cili është vlerësimi juaj për këtë pozitë?

Bahri Hyseni: Puna në komisione kërkon përqendrim profesional e sidomos kur është fjala për Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi sepse përveç faktit që jemi komision funksional e kemi për obligim edhe rishqyrtimin e të gjitha ligjeve tjera që procedohen në Kuvend. Por, krahas përgjegjësi që ka komisioni në fjalë, ne do të bëjmë edhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjeve, kohezionin në mes dispozitave ligjore e më së tepërmi do të angazhohemi për rekomandimet që do i japim qeverisë për nxjerrjen e Udhëzimeve Administrative, që jo rrallë deri më tani kanë qenë si pengesë për zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi.

Gjithsesi, do të përpiqem për bashkëpunim të mirë dhe të sinqertë në mes të gjitha komisioneve, si dhe për bashkëpunim me sponsorizuesit e ligjeve dhe të gjithë mekanizmat tjerë të cilët do të ofrojnë ndihmë që ligjet të jenë sa më profesionale e praktike. Nuk mund të harrojmë që ne jemi të



obliguar që të gjitha ligjet tona duhet të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së.

ASI: A mendoni se Kuvendi dhe Qeveria do të mund të koordinohen më mirë në hartimin e Agjendës Legjislative?

Bahri Hyseni: Gjithsesi, unë mendoj se do të ketë një koordinim shumë më të mirë në rend të parë se jemi në legjislaturën e tretë dhe kemi krijuar një përvojë dhe kulturë të punës dhe koordinimit. Çështje tjetër me interes është se komisioni në fjalë është liruar nga disa përgjegjësi që i kishte në legjislaturat e më parme dhe tërë energjinë e punës do ta përqendroj në sferat e ligjeve dhe të gjyqësisë. E padyshim se suksesi do të varet shumë nga bashkëpunimi. Po unë asnjëherë nuk dyshoj

në sinqertin e qeverisë për punë andaj edhe do të bashkëpunojmë shumë ngushtë.

ASI: Një nga funksionet kryesore të Komisionit ka të bëjë monitorimin e zbatimit të ligjeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Kosovës. Cili është opinionin i juaj mbi këtë çështje?

Bahri Hyseni: Nga të gjitha ligjet që janë të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, që janë rreth 200 ligje, janë monitoruar vetëm një numër simbolik i tyre. Unë konsideroj se nuk është një gjë me të cilën mund të krenohen deputetët e legjislaturave të kaluara.

Por, jam i bindur se kjo legjislaturë e ka të qartë rëndësinë e monitorimit. Në mënyrë që ligjet e aprovuara në Kuvend të mos mbesin vetëm si numër, ne duhet të mbikëqyrim zbatimin praktik, që t'i shërbejnë interesit të qytetarëve.

Një gjë e di se në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë që të përsëriten rastet kur Udhëzimet Administrative apo edhe vendimet kanë ndryshuar ligjet.

ASI: Sa i përket pranisë së ministrave në takimet e Komisionit kur një gjë e tillë është kërkuar nga Komisioni, çka mendoni ju për këtë?

Bahri Hyseni: Unë mendoj se është interes i përbashkët që sponsoruesi i ligjit ose ministria përkatëse që të kuptojnë se kur një kërkesë e komisionit bëhet për një gjë të tillë atëherë është me rëndësi që ministri apo zv/ministri të jetë në takim për të shpjeguar arsyeshmërinë e ligjit, interesin e përgjithshëm nga ai ligj apo çështje tjera me interes.

Ministrat edhe ashtu janë të obliguar me rregullore që ti përgjigjen ftesës nga ana e komisionit për të arsyetuar apo sqaruar çështje lidhur me ligjet, por në pamundësi për të prezantuar ata obligohen që ti autorizojnë, zv/ministrin apo zyrtarët tjerë të lartë të cilët kanë njohuri për ligjin apo sferën të cilën e mbulon ligji.

Barazia gjinore është e domosdoshme në një vend demokratik

Nga Besa Gaxherri, Deputete e Kuvendit të Kosovës,
Lidhja Demokratike e Dardanisë



Për të folur për këtë temë është e domosdoshme të kthehemi për disa momente në historinë e dhimbshme të Kosovës. Duke pasur parasysh se ky popull ka kaluar nëpër shekuj më shumë vështirësi historike e politike, me ngecje ekonomike, si dhe me një mentalitet Ballkanik, pasojat e këtyre proceseve në shekuj më së keqi i ka përjetuar apo pasojat më të rënda kanë qenë tek femra shqiptare. Përveç anashkalimit të gruas, shtypjes dhe diskriminimit që i është bërë ajo nëpër shekuj shpesh ka qenë viktime dhe jeta e saj ka përfunduar tragjikisht jo vetëm nga shtypja e sistemit por edhe nga vetë mentaliteti Ballkanik.

Nëse fillojmë të flasim për mundësitë e barabarta në zhvillimin e politikave që nga viti 1999-2000, mund të them se nga ky vit apo nga ky shekull gruaja në Kosovë ka filluar një etapë të re të zhvillimit jo pa sfida por së paku kontributin e vetë e jep në kushte të lirisë me të plotë në tërë kuptimin e fjalës, ani pse lë shumë për të dëshiruar.

Edhe në këtë etapë të zhvillimeve historike të Kosovës, gruaja më shumë është e angazhuar për të realizuar ëndrrën e popullit, pra Pavarësinë e Kosovës se që të merret me vetveten. Tashmë në Kosovë është në fuqi ligji për Barazi Gjinore, me të cilin përveç shumë të drejtave

dhe përgjegjësi që i mundësohen me këtë ligj asaj i garantohet edhe 30% e pjesëmarrjes në Kuvendin e Kosovës dhe në Kuvendet Komunale. Nëse kemi parasysh përqindjen e gjinisë femërore që është mbi 50% e popullsisë, si dhe nëse kemi parasysh statistikën nga universitetet ku më shumë ndjekin studimet femrat se meshkujt atëherë kurrësi nuk mund të jemi të kënaqur me pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e politikave në Kosovë.

Unë mund të them me plotë përgjegjësi dhe me kënaqësi se tashmë në Kosovë ka mjaft femra të përgatitura profesionalisht, të guximshme që të marrin të gjitha përgjegjësitë në të gjitha sferat e zhvillimeve në Kosovë. Dhe çka është më e rëndësishmja ato kanë vullnet për të punuar për ndryshime të domosdoshme në Kosovë, por pyetja është a kanë hapësirë të mjaftueshme për të dhënë kontributin e dodomosdoshëm? Unë mendoj jo!

Në këtë drejtim ndikojnë shumë faktorë: zhvillimet politike (historike), gjendja e rëndë ekonomike, sociale, funksionimi i shtetit ligjor, emancipimi i shoqërisë si dhe faktori më kryesor, këmbëngulësia më e madhe e gruas që ajo të jete e barabart në shoqëri.

Krahas shumë punëve dhe sfidave që presin Kosovën pas Pavarësisë, për femrën do të jetë punë shtesë që përveç punës profesionaliste të saj ajo duhet të japë ende më shumë energji që ta zërrë vendin e vetë në shoqëri.

Një shtet ligjor demokratik me një pjesëmarrje më të madhe të femrës në bërjen e politikave dhe ekzekutimin e tyre do të jetë shumë më funksional, më cilësor, me një zhvillim ekonomik më të shpejtë, shumë më pak korrupsion, arsimim dhe edukim më cilësor, sistem evropian shëndetësor e kështu me radhë. E rëndësishme është se në Kosovë krahas zhvillimeve pozitive në përgjithësi edhe barazia gjinore po ecën në drejtimin e duhur.

Përvoja ime si deputete

*Nga Safete Hadërgjonaj, Deputete e Kuvendit të Kosovës
nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)*



Mendoj se një punë e mirë që është bërë në legjislaturën e kaluar ka qenë ndryshimi i rregullores së punës. Ky ndryshim i rregullores ka mundësuar që nga qershori i vitit 2006, në çdo seancë të jetë pikë e rendit të ditës “koha për pyetje parlamentare” për të cilat janë rezervuar 50 minuta. Ndryshimet po ashtu kanë shkurtuar procedurat për interpelancë ku na është mundësuar që ne si deputet të adresojmë në Qeveri shqetësimet tona dhe të qytetarëve. Unë kam shfrytëzuar hapësirën për pyetje parlamentare, Qeverisë (Kryeministrit dhe Ministrave) u kam drejtuar 11 pyetje parlamentare, ku në dy pyetje nuk kame marrë përgjigje.

Detyrë kryesore e Kuvendit që kërkon më së shumti punë dhe angazhim të deputetëve e sidomos të komisioneve parlamentare e në veçanti të KBF është miratimi i buxhetit. Debatimi për buxhet është ngjarja më e theksuar gjatë vitit

parlamentar.

Dua të theksoj se gjatë amendamentimit të projekt buxhetit jemi përballur edhe me vështirësi. Projekt buxheti nga Qeveria zakonisht ka ardhur me të dhëna sintetike dhe me kot kemi kërkuar të dhëna analitike gjë që ka vështirësuar punën tonë për të dhënë rekomandimet. Po ashtu ka ardhur me vonësë.

KBF ka përgjegjësinë për kontrollimin e raporteve periodike dhe vjetore. Sipas nenit 40 dhe 41 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave duhet të dorëzojë Kuvendit raportin tremujor 30 ditë pas përfundimit të tremujorit dhe raportin vjetor 3 muaj pas përfundimit të vitit. Gjatë mandatit të kaluar vija e komunikimit me MEF nuk ka qenë në nivel, jo gjithmonë raportet kanë ardhur në komision. Ministri disa herë nuk i është përgjigjur ftesës së komisionit

për shqyrtimin e këtyre raporteve dhe për të diskutuar për prioritetet buxhetore.

Në legjislaturën e kaluar nuk kemi pasur si të themi një partneritet me zyrën e auditorit për të përcjell shfrytëzimin efektiv dhe efikas të buxhetit, kjo mbetet një sfidë e punës tonë në të ardhmen.

Të gjitha ligjet e miratuar në Kuvend kanë kaluar përmes KBF, ku janë shqyrtuar implikimet buxhetore për vitin e parë dhe vitet në vazhdim dhe i janë dhënë rekomandimet Kuvendit.

Për ligjet me interes të përgjithshëm kemi mbajtur debate publike, ku si komision jemi angazhuar që me kujdesin më të madh të marrim opinionet e pjesëmarrësve në dëgjimet publike. Kemi marrë në konsideratë rekomandimet nga institucionet ndërkombëtare, dhe jemi përpjekur të shfrytëzojmë praktikatat më të mira të cilat janë në rajon dhe në shtetet e BE. Edhe pse nuk ka munguar përkrahja e Komisionit nga NDI, OSBE, AER, nga “Projekti për ndihmë Kuvendit”, ekspert të përherëshëm të angazhuar në KBF nuk ka pasur gjë që ka vështirësuar punën tonë.

Një përvojë e mirë e imja në legjislaturën e kaluar ka qenë pjesëmarrja në Komisionin Hetimor Parlamentar që ka hetuar Raportin e Zyrës së Auditorit Gjeneral për të Gjeturat Faktike në Kuvendin e Kosovës. Komisioni në mungesë të ligjit për hetim parlamentar, në fillim të punës ka hartuar rregulloren e punës, planin veprues me dinamikën e përcaktuar kohore dhe kornizën metodologjike për shqyrtimin e çështjeve kryesore. Formimi i këtij komisioni ka hap mundësi të flitet për transparencë dhe mendoj se ky komision ka ofruar një raport përmbajtësor, profesional dhe logjik me punën që ka bërë në mënyrë intensive gjatë tre muajve.

Angazhim shtesë në mbikëqyrje të ligjeve dhe shpenzimeve të qeverisë

*Intervistë me Z. Naser Osmani, deputet në Kuvendin e Kosovës
dhe ish-kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa gjatë legjislaturës 2004-07*

ASI: Z. Osmani, cili është roli i Komisionit për Buxhet dhe Financa në mbikëqyrjen parlamentare ndaj ekzekutivit?

Naser Osmani: Mbikëqyrja parlamentare e Komisionit për Buxhet është e përshkruar në Kornizën Kushtetuese, si pjesë e obligueshme e punës dhe veprimtarisë së këtij komisioni, që është njëherit edhe komisioni kryesor parlamentar. Përveç tjerash, parashihet që ky komision të mbikëqyr shpenzimet e të gjitha institucioneve të Kosovës, respektivisht të gjitha organizatatve buxhetore që bëjnë shpenzime nga buxheti i Kosovës, duke përfshirë Presidencën, Qeverinë, Parlamentin dhe të gjitha institucionet tjera.

Komisioni nuk ka ndonjë mekanizëm të veçantë për mbikëqyrje, përveç raportimeve të obligueshme që vijnë nga Qeveria, respektivisht nga Ministria për Financa dhe Ekonomi (MEF) që është e obliguar t'i raportojë parlamentit, siç është e paraparë në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Po ashtu, Komisioni merr raporte nga Zyra e Auditorit Gjeneral dhe në bazë të tyre bën shqyrtimin dhe analizën e raporteve, i bën rekomandime Kryesisë, dhe nëse Kryesia e radhit në seancë, atëherë Komisioni për Buxhet bën paraqitjen e konkluzave që dalin nga ndonjë mbikëqyrje e caktuar.

ASI: Cili është roli dhe funksioni i Komisionit për Buxhet dhe Financa në procesin e miratimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës?

N.O.: Roli kryesor i Komisionit është shqyrtimi dhe amandamentimi i Ligjit të Buxhetit, i cili është dokumenti kryesor juridik që aprovohet çdo vit në formë të ligjit në Kuvend. Në shtetet demokratike, Kuvendi është organi i fundit që miraton buxhetin vjetor, mirëpo në rrethanat tona ligji për buxhet përveçse në Kuvend, kalon edhe nëpër disa procedura tjera si nëpër Këshillin Ekonomik Fiskal, i cili është një organ që edhe pas miratimit nga Kuvendi, edhe njëherit e shqyrton dhe i propozon PSSP-së që ta nënshkruajë ligjin si të plotfuqishëm.

Komisioni për Buxhet, përveç që merr pjesë në dëgjimet buxhetore në MEF gjatë hartimit të buxhetit për organizatat buxhetore, organizon dëgjime buxhetore për ato institucione që i konsideron më të



rëndësishme, merë parasysh propozimet e tyre, me fjalë të tjera e rishqyrton draft buxhetin dhe ja paraqet Kuvendit për aprovim në formë të amandamentuar.

Detyra themelore e komisionit është që të bëjë edhe monitorimin e implementimit të ligjeve. Janë disa ligje për të cilat duhet të ketë kujdes më të madh sepse janë ligje specifike që prejudikojnë disa dukuri negative, andaj duhet të jenë nën vëzhgim më të madh nga ana e organeve legjislative. Unë po përmend Ligjin për Prokurim, i cili ka specifikat e veta, është brenda standardeve të BE-së dhe mbikëqyret.

ASI: Si i cilësoni marrëdhëniet e Komisionit me institucionet e pavarura?

N.O.: Një komunikim që nuk ka mundur të zhvillohet në dy mandatet e kaluara është ai i relacionit të Kuvendit me Zyrën e Auditorit Gjeneral. Insistimi ynë i vazhdueshëm ka qenë që të nxirret ligji për auditimin e jashtëm. Ky ligj do të rregullonte më mirë përgjegjësit e raportimit të këtij institucioni Kuvendit të

Kosovës, ku inicimin e këtij ligji ta bëjë vetë zyra e auditorit gjeneral. Edhe pas përpjekjeve nga agjensioni evropian që të bëhet një draft, ai është tërhequr në kuptimin e asaj që t'i lihet edhe më tutje kompetencë e kësaj zyre e mos t'i kalohet organeve vendore. Po ashtu duhet të ndërhyhet në ligjet e zyrave rregullative, agjencioneve dhe të autoriteteve tjera, që të përcaktohet më me saktësi pavarësia e tyre sidomos ajo financiare.

ASI: Çfarë rekomandimesh keni për komisionin e ri?

N.O.: Kolegëve në komision u kisha rekomanduar që ta përshpejtonë procedurën e nxjerrjes së atyre ligjeve që janë proceduar në Komision për Buxhet dhe Financa e që nuk kanë arritur të aprovohen për shkak të përfundimit të mandatit, siç janë ligji për parandalimin e pastrimit të parave, pasi që kjo nënkupton dhe bartjen e kompetencave tek vendoret për këtë çështje, ligji për tatimin në vlerën e shtuar etj. Të jenë më të kujdesshëm në shqyrtimin e draft buxhetit, sidomos të përcaktohen se a janë dokumentet e ofruara nga qeveria në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e financave publike, posaçërisht në pjesën që ka të bëjë me investimet kapitale. Thjeshtë, ta shtojë angazhimin e vet në mbikëqyrjen e ligjeve që mund të prejudikojnë dukuri negative dhe të përcjellin shpenzimet e qeverisë me "llupë".

ASI: Çka mund të thoni për amandamentimin e ligjit për menaxhimin e financave publike?

N.O.: Konsideroj se ky ligj duhet të trajtohet me kujdes të veçantë sepse vlerësimet tona dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare në Kosovë japin vlerësime shumë pozitive për këtë ligj. Ne vazhdimisht kemi përmendur se ky ligj duhet të plotësohet në momentin kur është dashur të mblidhen shqyrtohet ndonjë nga ligjet që nuk janë në përputhje me këtë ligj, siç është çështja e fondeve që nuk parashihen në këtë ligj si Fondi pensional, fondi për i sigurimeve shëndetësore, apo fondet i e rrugëve, etj. çështje që ky ligj nuk i parasheh në formën e tashme.

Intervistoi: Lumni Rama,
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Mbështetja e Administratës për deputetët

Daut Beqiri, Drejtor i Departamentit Ligjor në Kuvendin e Kosovës

Organizimi dhe përgjegjësitë e gjithmbarshme të Administratës së Kuvendit si dhe funksionimi i brendshëm administrativ i saj, përcaktohet me Rregulloren për statusin e shërbyesve civil të Kuvendit të Kosovës. Administrata e Kuvendit të Kosovës, nën përgjegjësinë e Sekretarit, ofron shërbime këshilluese juridike – ligjore e procedurale, shërbime përmbajtësore administrative, teknike - ndihmëse dhe si dhe shërbime tjera përkatese për Kuvendin e Kosovës dhe organet e tij. Administrata e Kuvendit, ofron edhe shërbime tjera ndihmëse të përcaktuara nga Kryesia e Kuvendit dhe Kryetari i Kuvendit.

Struktura organizative dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit

Administrata e Kuvendit përbëhet nga struktura në vijim:

- Zyra e sekretarit me tri njësi: Shërbimi i deputetëve, Seksioni për Media dhe marrëdhënie me publikun dhe Seksioni për marrëdhënie ndërkombëtare dhe Protokoll.
- Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale dhe
- Departamenti i administratës.

Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit

Sekretari i Kuvendit është udhëheqësi kryesor i Administratës së Kuvendit. Atë e emëron dhe për punën e tij i përgjigjet Kryesisë së Kuvendit. Ai i kryen detyrat në koordinim të afërt me Kryetarin e Kuvendit.

Sekretari i Kuvendit, përveç tjerash, është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të Administratës së Kuvendit dhe



kujdeset për zbatimin e detyrave dhe miratimin e udhëzimeve administrative që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e administratës, ofron udhëzime dhe këshilla të sakta, të paanshme dhe profesionale për kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit si dhe përkujdeset për menaxhimin efektiv dhe efikas të mjeteve buxhetore që i ndahen Kuvendit në pajtim me ligjin dhe rregullat e brendshme buxhetore të Kuvendit.

Departamenti për shërbime procedurale dhe ligjore është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes me shërbime këshillëdhënëse juridike, legjislative dhe procedurale organeve të Kuvendit, deputeteve dhe seancës plenare përmes nëpunësve-shërbyes civil.

Departamenti ligjor përbëhet nga tri divizione:

Divizioni për çështje plenare dhe procedurale me Njësinë për propozime e parashtresa, Njësinë për çështje plenare dhe procedurale dhe Njësinë e transkriptimit dhe lekturës. Është përgjegjës për pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e projektligjeve, amendamenteve të

propozuara në projektligje, raporteve me rekomandime, mocioneve /propozimeve/ të deputetëve, kërkesave për interpelancë, pyetjet e deputetëve për kryeministrin dhe për ministrat. Benë përgatitjen e rendit të ditës, hartimin e procesverbaleve dhe transkriptimit për mbledhjet e Kryesisë dhe për seancat e Kuvendit, materializimin e vendimeve si dhe publikimin në ueb faqen e Kuvendit.

Divizioni për mbështetje të komisioneve të Kuvendit, është përgjegjës për ofrimin e këshillave juridike e procedurale gojore dhe ekspertizës meshkrim komisioneve parlamentare lidhur me çështjet e caktuara ligjore, ose procedurale për punën e komisioneve, këshillimi dhe asistimi i drejtpërdrejtë në hartimin e projektligjeve dhe amendamenteve, radhitjen e tyre për procedim në shqyrtimin e dytë, hartimin e planit të punës për komisione, hartimin e procesverbaleve dhe Raporteve me rekomandime për Kuvendin.

Divizioni për standardizim ligjor, këshillim juridik, kërkim, Librari dhe Arkiv ofron mbështetje për hartim të legjislacionit dhe hartimin e amendamenteve, siguron standardizimin gjuhësor i teksteve të Projektligjeve të propozuara dhe ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës, në gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe gjuhën angleze, kujdeset për standardizimin juridik nga aspekti i teknikës juridike dhe i metodologjisë unike për të gjitha projektligjet që i propozohen Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe miratim, kujdeset për përafrimin

dhe harmonizimin e legjislacionit me acquis communautaire dhe me standardet ndërkombëtare, kujdeset për ofrimin e shërbimeve efikase lidhur me dokumentacionin e Kuvendit, shërbimin librar, revistat, dokumentet dhe hulumtimet nga data qendrat dhe qendrat tjera të librarisë dhe dokumentacionit. Siguron ofrimin e shërbimeve kërkimore me kërkesë të deputetëve.

Departamenti i Administratës ofron mbështetje për shërbimet profesionale administrative, teknike dhe ndihmëse deputeteve dhe organeve të Kuvendit përmes zyrtarëve nga Divizioni i Buxhetit, Divizioni Teknik, Seksioni i Teknologjisë Informative, Seksioni i Personelit, Seksioni i Prokurimit dhe Seksioni Gjuhësor.

Divizioni për buxhet siguron planifikimin, përcjelljen dhe ekzekutimin e shpenzimeve të buxhetit që të jenë në përputhje me rregullat financiare dhe ligjin e aplikuar në Kosovë si dhe përgatitjen e raporteve tremujore dhe vjetore të buxhetit të Kuvendit.

Divizioni teknik është përgjegjës për shërbimin teknologjik informativ përfshirë këtu edhe sistemin për menaxhimin e dokumenteve, shpërndarjen, vendosjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve në të gjitha zyrat, iniciimin e furnizimeve, shërbimin e transportit, shërbimin e shtypje, postës si dhe punëve të tjera teknike.

Seksioni i personelit përkujdeset për zbatimin e rregullave statusore të stafit civil të Kuvendit, menaxhimin me procedurat për konfirmimin e punësimit, emërimin në vend të punës dhe pensionimin e të

Programi hyrës për deputetët e rinj të Kuvendit të Kosovës

Nga Artan Canhasi, Misioni i OSBE-së në Kosovë

punësuarve në Administratën e Kuvendit, me trajnime, procedura disiplinore dhe kontrata pune për stafin politik.

Divizioni për prokurim është përgjegjës për iniciimin dhe kryerjen e procedurës së furnizimit apo të ndonjë aktiviteti që ka për qëllim ndonjë kontratë sipas nevojave të Kuvendit në përputhje të plotë me ligjin për Prokurim

Seksioni për marrëdhënie ndërkombëtare dhe Protokoll është përgjegjës për mbështetje në pranimin e delegacioneve të huaja dhe organizimin e vizitave ndërkombëtare të Kryetarit, Kryesisë dhe delegacionit të deputetëve të Kuvendit.

Seksioni për Media dhe marrëdhënie me publikun është përgjegjës për komunikimin institucional të Kuvendit, veçanërisht për veprimet legjislative brenda Seancave Plenare dhe Komisioneve, për plasimin dhe publikimin e informatave dhe dokumenteve, komunikatave për shtyp, informatave lidhur me aktivitetet si dhe organizimi i konferencave për shtyp për organet e Kuvendit si dhe për mirëmbajtjen e Uebfaqes së Kuvendit;

Seksioni për përkrahjen e deputetëve është përgjegjës për menaxhimin, evidentimin dhe shpërndarjen e dokumenteve për deputetë, sigurimi me informatat logjistike për deputetë, organizimin dhe menaxhimin me zyrat për mbledhje të organeve të Kuvendit dhe përkrahja në komunikimin me institucione të tjera publike jashtë Kuvendit.

Programi hyrës pesë ditorë për deputetët e ri të zgjedhur të Kuvendit të Kosovës u organizua nën përkujdesjen e Kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, dhe u përkrah nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe USAID.

Meqë gjysma e deputetëve të Kuvendit të Kosovës zënë vendet e tyre për herë të parë, kishte nevojë për një prezantim më gjithëpërfshirës për praktikatat demokratike parlamentare dhe për reformat dhe standardet e arritura nga Kuvendi në mandatet e mëparshme. Prandaj, në dy muajt e fundit, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe partnerët e tij në "Iniciativa për Përkrahje të Kuvendit" (ASI) në bashkëpunim me Sekretariatit e Kuvendit kanë përgatitur një program hyrës për deputetët e ri të Kuvendit.

Programi hyrës pesë ditor filloi më 24 janar 2008. "Programi mbulon tri funksionet kryesore të Kuvendit: legjislativin, mbikëqyrjen dhe funksionin përfaqësues, si dhe një prezantim të përgjithshëm se si Kuvendi i kryen punët që ka përmes Komisioneve, Grupeve Parlamentare dhe Kryesisë me përkrahjen e Sekretariatit", sqaroi z. Franklin De Vrieze, Udhëheqës i Seksionit të Misionit të OSBE-së për Kuvendin Qendror dhe Partitë Politike.

Në fjalimin hyrës të programit, Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi ua përkujtoi deputetëve të ri se "të qenit deputet i Kuvendit të Kosovës jo vetëm që është privilegj, por mbi të gjitha është përgjegjësi që kërkon përkushtim të përditshëm për t'i përfaqësuar qytetarët me dinjitet". Deputetët e ri



kishin mundësinë që të marrin informata FIRST HAND mbi rolin e Kryetarit të Kuvendit nga ish Kryetari z. Kolë Berisha si dhe për rolin e Kryesisë së Kuvendit nga z. Sabri Hamiti. Roli i Komisioneve, ku kryhet shumica e punës së Kuvendit, u prezantua nga z. Fehmi Mujota dhe Naim Maloku.

Një komponentë kyçe në program ishte roli i Kuvendit sa i përket llogaridhënies qeveritare dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Deputeti i Kuvendit z. Hydajet Hyseni theksoi se "Deputetët kurrë nuk duhet të bëjnë dallim midis komuniteteve, ata janë përfaqësuesit e të gjithë popullit të Kosovës". Si deputet i ri i Kuvendit të Kosovës z. Slobodan Petrović, Kryetar i Partisë Liberale Serbe SLS, foli mbi detyrën e sfidues për deputetët serb të Kuvendit për të ngritur legjitimitetin në sytë e popullit serb të Kosovës, dhe si rrjedhim për nevojën që IOVQ-të t'ju dalin në ndihmë dhe të dalin me rezultate të politikave konkrete, veçanërisht në këto çaste të ndjeshme të zhvillimeve politike në Kosovës.

Gjatë programit hyrës, Sekretariati i Kuvendit gjithashtu kishte mundësinë t'i informojë deputetët e ri për përkrahjen që ata do ta marrin gjatë mandatit të tyre.

Misioni i OSBE-së e përkrahu programin duke siguruar ekspertizë parlamentare dhe duke asistuar në zhvillimin programor. Misioni i OSBE-së gjithashtu i dha prioritet kalimit të njohurive nga deputetët më të vjetër të Kuvendit të Kosovës tek deputetët më të ri, duke promovuar kështu qëndrueshmërinë e institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës do t'i raportojë Kuvendit

Intervistë me Sevdail Kastratin, kryesues i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës



ASI: Çka është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (KPM)?

Sevdail Kastrati: KPM-ja është një këshill i cili mbikëqyrë pajtueshmërinë me Ligjin e Shërbimit Civil, përfshirë rishikimin e emërimeve të krerëve të departamenteve dhe dëgjimin e apeleve të ankesave të punonjësve të shërbimit civil. Ne mbajmë seanca dëgjimi dhe marrim vendime për rastet e sjella nga shërbyesit civilë dhe i shkojmë të autoritetet e punësimit për monitoruar pajtueshmërinë me ligjin. Ekzistojnë shtatë anëtarë të Bordit që reflektojnë bilancin gjinor dhe përfaqësimin e komuniteteve pakicë. Aktualisht KPM-ja është njësi autonome e financuar nga buxheti i Ministrisë së Shërbimeve Publike. Megjithatë, rregullorja origjinale e UNMIK-ut parasheh transformimin e KPM-së në institucion tërësisht të pavarur që i raporton drejtpërdrejt Parlamentit. Ky ndryshim në rregullore është pajtuar nga grupi punues i kryesuar nga Zyra e Kryeministrit dhe është në fazën përfundimtare të tij.

ASI: Sipas jush, cilat janë të

arriturat kryesore të KPM-së?

SK: Funkzioni më i rëndësishëm i KPM-së është që shërbyesve civilë të cilët janë në pajtueshmëri t'i ofrojë mundësinë për t'u dëgjuar para një organi të pavarur. Ne kemi qenë të suksesshëm duke i komunikuar shërbyesve civilë se është një organ përgjegjës për apele përfundimtare ndaj ankesave të tyre. Ne i marrim vendimet tona në pajtim me ligjin, pa presion nga jashtë. Këshilli ka filluar dëgjimin e apeleve në vitin 2006, duke pranuar 186 apele nga të cilat 129 janë zgjidhur. Në vitin 2007, ngarkesa jonë e punës është rritur dhe kemi pranuar 384 apele nga të cilat i kemi zgjidhur 386 (përfshirë disa nga viti i kaluar). Kthimi i shpejtë i vendimeve është një nga arsytet pse unë mendoj se KPM ka zhvilluar kredibilitet. Në disa raste, shkarkimi i punonjësve është ndryshuar si rrjedhojë e vendimeve tona.

ASI: Cili është procesi i transformimit të KPM-së dhe çka pritni nga Kuvendi i Kosovës?

SK: Sipas rregullores aktuale në zyrarisht gjendemi brenda

Ministrisë së Shërbimeve Publike (MShP) dhe plotësisht mbështetemi në MShP-në për sa i përket buxhetit tonë, stafit dhe resurseve. Edhe nëse lidhja me ministrinë është vetëm nominale, ajo mund të krijojë pengesa në perceptimin tonë si tërësisht të pavarur nga autoritetet e punësimit. Gjithashtu, mund të shkaktojë huti në mes të Ministrive, sepse disa ministri pyesin se pse ka kontroll dhe rishikim të ministrisë ndaj të tjerëve. Pasi të ketë përfunduar transformimi, nedot'iraportojmë Parlamentit. Kjo do të na jep më shumë legjitimitet sepse në vend se t'i raportojmë një pale apo një Ministrie, ne do t'i raportojnë një organi i cili është i përbërë nga të gjitha partitë. Parlamenti do të jetë në gjendje të rishikojë dhe debattojë raportet tona, përfshirë rastet e mospajtueshmërisë me vendimet tona, si dhe do të nxjerren rekomandime për veprimet që do të merren nga qeveria. Komisionet e Kuvendit mund të ndihmojnë edhe në garantimin e pavarësisë sonë duke siguruar se kemi financa dhe staf të mjaftueshëm për të kryer punën tonë në mënyrë efektive.

ASI: Cilat janë shpresat dhe

planet tona për të ardhmen?

SK: Ne shpresojmë se procesi i transformimit do të ngjajë sa më parë që është e mundur. Ne do të gëzojmë kredibilitet më të madh nga shërbyesit publikë dhe autoritetet e punësimit si arbitër i drejtë dhe i paanshëm i dallimeve. Ne kemi pasur disa trajnime stërvitje të rregullta përfshirë një vizitë në Kanada të sponsorizuar nga OSBE-ja. Ne jemi të gatshëm për të filluar zbatimin e njohurisë sonë, përmes zgjerimit të punës sonë për të përfshirë ndërmjetësimin dhe format tjera të zgjidhjes së kontesteve. Duke siguruar se shërbyesit publikë zgjidhen dhe mbahen në bazë të meritës, në do të sigurojmë edhe një bazë më të mirë për qeverisë të mirë në Kosovë, sepse ata që administrojnë dhe i shërbejnë popullit të Kosovës do të jenë të kualifikuar mirë dhe pa presione politike. Unë mendoj se KPM është një lajm i mirë për momentin në mënyrën e zhvillimit të institucioneve të Kosovës krahas standardeve ndërkombëtare demokratike dhe të qeverisjes së mirë.

Intervistë nga Anita Vandebeld,
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Fundi i projektit të financuar nga BE-ja "Përkraja e mëtejshme për Kuvendin e Kosovës"

Hugues de Courtivron, Udhëheqës i Ekipit të Projektit "Përkraja e mëtejshme për Kuvendin e Kosovës"

Bashkimi Evropian ka financuar 1.5 milion euro për një projekt të dytë për të përkrahur Kuvendin e Kosovës. Projekt i menaxhuar nga AER-i i ishte besuar një konsorciumi të udhëhequr nga French Assemblée Nationale me Bundestagun e Gjermanisë, Dhomës Belge të Përfaqësuesve, Kuvendit Kombëtar të Sllovenisë dhe një OJQ-je Franceze, Institut International de Paris La Défense). Projekti filloi në janar të vitit 2006 dhe përfundoi në janar të vitit 2008.

Disa mësimë

Koncepti i shfrytëzimit të një ekipi nëpunësish civil nga Kuvendet e vendeve Evropiane, me punë si sekretarë apo këshilltarë të presidencës, mund të konsiderohet si jashtëzakonisht efikase për të adresuar çështjen e ndërtimit të institucionit parlamentar. Të gjithë ekspertët afatshkurtër që erdhën për të këshilluar, mbanin pozita të përhershme në fusha të njëjta me të cilat janë marrë në Kuvendet e tyre përkatëse.

Marrëdhëniet e mira të punës të ndërtuara me deputetët dhe stafin e administratës, në veçanti puna e bërë me sekretarin dhe anëtarin e mëparshëm të Kryesisë së Kuvendit, z. Gazmend Muhaxheri, konsiderohen elemente shumë të rëndësishme për suksesin e Projektit.

Një nga pikat kyçe në synimet e arritura dhe në rifuqizimin e autoritetit të sekretarit, ishte vendimi i Kryesisë për t'i pyetur disa nga anëtarët e saj për të mbikëqyrur disa fusha kyçe të administratës.

Ndërtimi i një kuvendi demokratik është proces i gjatë,

por bazat tani janë vendosur dhe Kuvendi mund të mburret me atë që është arritur.

Arritjet kryesore

Reforma kyçe e organizimit të administratës u miratua në prill të vitit 2007. Për herë të parë, njëzetedy punonjës janë rekrutuar në mënyrë transparente. Statuti i shërbyesve civil të Kuvendit tani është themeluar; mbetet të plotësohet me përshkrimet e hollësishme të punës.

Koordinimi me Qeverinë dhe UNMIK-un është përmirësuar: janë vendosur kontakte të rregullta, në veçanti sa i përket shqyrtimit të dyzet ligjeve të cilat ende nuk janë shpallur nga PSSP-ja.

Përgatitja e agjendës plenare është përmirësuar ndonëse ende ka çështje pezull për të gjetur konsensus në mes grupeve politike sa i përket ndarjes së kohës.

Projekti gjithashtu ka përkrahur Sekretariatit në përgatitjen dhe shqyrtimin e disa rregulloreve për Zyrën e Pranimit, mbi publikimin e procesverbaleve, për buxhet, prokurim dhe menaxhim, për menaxhimin e dokumentacionit, për mediat dhe punën protokolare, si dhe për arkivin dhe librarinë.

Një qëllim kryesor i Projektit ka qenë të përforcohet kapaciteti menaxhues i autoriteteve të Sekretariatit për të marrë vendime sipas fushës së tyre të kompetencës, nën mbikëqyrjen e Kryesisë, por pa intervenime të papërshtatshme politike.

Projekti përkrahu forcimin e autoritetit të Sekretarit në punën e tij/saj të përditshme dhe sugjeroi marrjen e vendimeve

për të përmirësuar funksionimin e Sekretariatit. Shumica e këtyre vendimeve kanë hyrë në fuqi.

Sistemi i TI-së (Teknologjisë Informativë) i Kuvendit është ende nën kontroll të Misnistrisë së Shërbimeve Publike. Kuvendi duhet të ketë më shumë autonomi në këtë çështje.

Projekti u përmbyll me rekomandime kyçe, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e reformave.

Në fushën e Kryesisë së Kuvendit:

- Të miratohet rregullorja e brendshme e punës së Kryesisë në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e reformave, që do të mund të lejonte një organizim në të përqendruar të Kryesisë në detyrat e saj primare (koordinimi i punës së Kuvendit dhe mbikëqyrja e Sekretariatit).
- Të përkrahet Sekretari duke i dhënë atij/asaj më shumë autonomi në menaxhimin e përgjithshëm të Sekretariatit.
- Të definohet ndarja e përgjegjësisë në mes pushtetit politik dhe Sekretariatit në përgatitjen dhe implementimin e buxhetit nën monitorimin e Kryesisë.
- Të miratohet draft vendimi i Kryesisë mbi Urdhëresën Interpretuese mbi Rregulloren për Rregullat Statutore për Shërbyesit Civil të Sekretariatit, draft Udhëzimin Administrativ për rregullat e ngritjes në pozitë/gradimit bazuar në vjetërsi dhe merita, dhe draft Udhëzimi Administrativ për Kodin e Mirësjelljes të stafit civil.
- Të rregullohet statuti i stafit politik të Kuvendit duke

miratuar draft udhëzimin administrativ.

- Të ndihmohet procesi me të cilin i jepet Kuvendit autonomi për dhënien e pagave.

Në fushën e Sekretarit:

- Të sigurohet që sistemi i ri i rekrutimit, i bazuar në kritere të paanshmërisë dhe transparencës, të implementohet në mënyrë të përpiktë.
- Të miratohet një plan rekrutimi trevjeçar.
- Të plotësohen vendet e punës që janë ende të lira.
- Të shmangen derogimet nga parimet e Statutit.
- Të implementohet shkalla e re e pagave dhe programi vjetor i trajnimeve
- Të themelohet një sistem i dhënies së pagave brenda Kuvendit.
- Të përgatitet një plan për sistem të ri dhe të modernizuar të TI-së.
- Të zhvillohen kapacitetet efikase menaxheriale në të gjitha njësitë organizative.
- Të kontrollohet implementimi i përpiktë i buxhetit dhe procedurave të prokurimit tashmë të jetësuar.
- Të kontrollohet implementimi i procedurave tashmë të jetësuar për Librarinë, Arkivin dhe menaxhimin e dokumentacionit
- Të përkrahet trajnimi për stafin e ri të rekrutuar, posaçërisht në Njësinë për Standardizim Ligjor, Harmonizimi dhe Këshillim Ligjor.
- Të përshpejtohet përmirësimi i faqes së internetit të Kuvendit.



Mirëseardhje për Ian Perkins, Drejtor Legjislativ i NDI

Ian Perkins ka më shumë se 20 vjet përvojë në operacione legjislative dhe politike në Kanada, ku ka mbajtur poste të larta në nivelin federal dhe ato krahinore dhe ka zhvilluar fushata zgjedhore për një sërë postes partiake dhe qeveritare. Gjatë punës së tij, ai ka udhëtuar gjerësisht nëpër Evropë, Azi dhe Afrikë; i ka vëzhguar zgjedhjet në Serbi, Kosovë dhe Somali; dhe mban dy nënshtetësi: atë britanike dhe kanadeze.

Përvoja e madhe parlamentare prej dy dekadash e Perkins-it në Kanada, shumë i shquar për kontributet e tij gjatë dy vjetëve si Këshilltar i lartë i Politikave i Ministrisë për Çështje të Veteranëve dhe 16 vjet si Shef i Stafit të një anëtarë të parlamentit, i cili ka shërbyer dy vjet si sekretar parlamentar i Ministrisë të Transportit. Gjatë punës së tij në këtë legjislaturë, Perkins ka përvojë të gjerë e të madhe në procedurat legjislative, aktivitetet në komisione dhe grupe parlamentare, kontaktim me zgjedhësit, hartimin e buxhetit dhe çështjet e barazisë gjinore. Përmes rolit të tij në Partinë Liberale të Kanadasë, Perkins ka shërbyer si drejtor kombëtar i fushatës dhe bërjes së fushatës dhe organizues i identifikimit të votuesve.

Jashtë punës së tij legjislative dhe të fushatës, Perkins ka punuar arkëtar në Klubin Kombëtar të Shtypit të Kanadasë, post ky që i kishte lejuar atij qasje dhe depërtim në punët e trupit kombëtar të shtypit të Kanadasë. Në ditën e kualifikimeve të tij të shquara, përvojës ndërkombëtare dhe ekspertizës së gjerë legjislative, në menaxhment dhe politikë, Perkins është i përgatitur mirë për të marrë përsipër përgjegjësitë si Drejtor Legjislativ i NDI në Kosovë.

Nga Carlo Binda, Drejtor i NDI

Përkrahja e punës së Kuvendit të Kosovës

Nga Franklin De Vrieze, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Që nga krijimi i Kuvendit të Kosovës në vitin 2001, Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka ofruar Kuvendit ndihmë substanciale. Në këtë artikull, ne do t'i shqyrtojmë llojet e ndihmës së OSBE-së gjatë muajve të fundit si dhe do të elaborojmë bashkëpunimin me organizatat tjera që ofrojnë ndihmë për Kuvendin.

Gjatë punës në partneritet me Kuvendin, kanë qenë tre programe kryesore që përkrahin Kuvendin gjatë mandatit të dytë: Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Konsorciumi i financuar nga BE-ja i katër parlamenteve Evropiane (Francë, Gjermani, Belgjikë dhe Slloveni) dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë. Ata koordinojnë punën e tyre nën ombrellën e "Iniciativës për Përkrahje të Kuvendit" (IPK). Qasja e IPK-së bazohet në një sistem të konsultimeve të rregullta mbi çështjet specifike të përkrahjes parlamentare pa një sistem të centralizuar të vendimmarrjes së imponuar. Objektivi i IPK-së është që të shmangët overlap dhe konkurrenca, si dhe të kontribuohet në ndihmën e përbashkët dhe plotësuese për Kuvendin. Koordinimi i kohës së punëtorive apo konferencave ka ndihmuar në shmangien e agjendave kontradiktore. Pas ca kohe, është themeluar njëسيا e punës dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive për bi ndihmën e ofruar për Kuvendin. Një gjë e tillë ka shpie në praktikën që projekte apo organizata specifike të ofrojnë përkrahje për komisionet specifike parlamentare në pajtim me projektet dhe organizatat tjera që ofrojnë ndihmë për komisionet tjera parlamentare. Disa herë, koordinimi përfshinte bashkëpunimin ndërmjet agjencive në fushën e vlerësimit të nevojës. Në disa raste, organizatat zhvillonin rekomandime apo propozime të përbashkëta për reforma në Kuvend. "Plani i Standardeve të Kuvendit" i qershorit të vitit 2006, konsultimet mbi çështjen e votimit të hapur të regjistruar dhe programi fillestar i vitit 2008 për deputetët e sapo zgjedhur, janë disa shembuj të "bashkimit intensiv të resurseve" në mes të organizatave dhe programeve të veçanta që punojnë për Kuvendin. Ndonëse qasja e koordinimit disa herë duhej të përballonte interesat e ndryshme, mund të thuhet se programet për zhvillimin e kapaciteteve që punojnë brenda Kuvendit ishin më të suksesshëm sesa agjencitë që punojnë në sektorë tjerë të jetës publike në shmangien

e mbingarkesës së përfituesve me aktivitetet dhe rekomandime kontradiktore.

Elaborimi i disa programeve specifike të OSBE-së me Kuvendin gjatë gjashtë muajve të fundit, tregon se janë disa të arritura që vlen të përmenden.

* Komisionet shqyrtojnë dhe revidojnë projekt-legjislacionin në kohë, që rezultoi në më pak ligje të kthyer në Qeveri sesa vitin e kaluar. Pesë komisione – Komisioni Legjislativ, Buxheti, Komuniteteve, Sigurisë dhe Mjedisit – hartojnë dhe implementojnë plane të punës, përfshirë bashkëpunimin rajonal parlamentar. Zyra ligjore e Kuvendit, stafi i komisionit dhe zyrtarët e zyrave për të drejta të njeriut pranë ministrive pranuan trajnim ligjor. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ndërmori më shumë vizita në terren sesa vitet e kaluara. Deputetët morën pjesë në takime me nxënës të shkollave të mesme (përfshirë nxënës të komuniteteve pakicë) për të diskutuar mbi rolin e Kuvendit dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të studentëve mbi arsimin dhe të drejtat gjuhësore të pakicave.

* Krerët e agjencitë të pavarura dhe Komisioni për buxhet dhe financa janë angazhuar në debatin e parë dhe intensiv lidhur me nevojat e buxhetit të agjencive të pavarura.

* Është publikuar një vlerësim i thellësishtëm procedural i punës së Kuvendit që mbulon periudhën nga gushti 2006 deri në nëntor 2007, përfshirë rekomandimet për e sapo inauguruar për përmirësimin e funksionimit të Kuvendit. Janë siguruar veglat për efikasitet më të madh në procesin legjislativ, përfshirë fjalorthin e termeve parlamentare, si dhe disa publikime tjera parlamentare.

* Grupet parlamentare janë ndihmuar përmes një programi të praktikës. Grupi parlamentar i grave në Kuvendin e Kosovës pranoi këshillime dhe përkrahje teknike.

* Sekretari përfitoi nga bashkëpunimi rajonal dhe këmbimi i përvojave përmes një

vizite në parlamentet fqinje. Një trajnim për përdorimin e teknologjisë kontribuoi në më shumë transparencë të Kuvendit.


* **Partnerët IPK-së koordinuan një trajnim fillestar për Deputetët e sapo-zgjedhur me Sekretariatit e Kuvendit.**

Gjatë vlerësimit të punës së Kuvendit të Kosovës në mandatin e dytë, janë identifikuar tri trende të dallueshme: (1.) një lëvizje drejt shqyrtimit të zbatimit të legjislacionit ndryshe nga vetëm miratimi i tyre; (2.) një ngritje e njohurisë dhe përdorimit të Rregullores së punës gjatë debateve politike dhe një rishikim vetë-përmirësues i pajtueshmërisë me Rregulloren e punës; dhe (3.) rritje e sigurisë e Kuvendit në ushtrimin e rolit të tij në rishikimin buxhetor, ndonëse zhvillimet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës mbesin nën autoritetin e Këshillit ekonomik fiskal.

Sfidat e ardhshme përfshijnë nevojën për zhvillim më të fortë të mbikëqyrjes parlamentare në fushat e sektorit të sigurisë, rishikimit buxhetor, çështjeve ekonomike dhe mjedisore. Një fushë e veçantë e vëmendjes është standardizimi i legjislacionit dhe harmonizimi i tij me “acquis communautaire” si dhe krijimi i një kornize gjithëpërfshirëse legjislative ku legjislacioni ekzistues dhe ai i ri janë në pajtim me kushtetutën e re të Kosovës. Kuvendi i ri pritet që të luajë një rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të zgjidhjes së statusit, përfshirë mbikëqyrjen e strukturave dhe kompetencave të reja politike që parapara në zgjidhjen e statusit, zbatimin e masave të reja mbrojtëse për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Sfida tjera janë themelimi i takimeve të rregullta në mes të Komisionit të buxhetit dhe krerëve të agjencive të pavarura për

të adresuar problemet buxhetore dhe masat mbrojtëse për pavarësinë e këtyre agjencive. Komisioni i sapokrijuar për punë të brendshme dhe siguri do të ketë nevojë për vëmendje të veçantë në fuqizimin e rolit të tij në mbikëqyrje, vendosje të politikave dhe mundësimin e ndërveprimit më të madh me publikun gjatë dëgjimeve dhe grupeve punuese. Kuvendi ka mundësi për të avancuar kapacitetin e librarisë për të ofruar përkrahje më profesionale për Deputetët. Kuvendi, po ashtu, ka mundësi për avancimin e transparencës përmes “Ditëve të hapura” (kur premiset e Kuvendit janë të hapura për publikun dhe për vizita), përdorimit të teknologjisë së komunikimit për të komunikuar me opinion publik. Duke fuqizuar rolin e vet në funksionet legjislative, të mbikëqyrjes dhe të përfaqësimit, Kuvendit i Kosovës do të rrisë autoritetin e tij gjatë viteve në vijim.



Dale Archer (NDI), Artan Canhasi, Franklin De Vrije (Misioni i OSBE-së në Kosovë)

Shoqëria Civile dhe Procesi Legjislativ në Kosovë

Nga Armend Bekaj, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Një studim analitik i kohëve të fundit ofron disa rekomandime kyçe sa i përket asaj sesi Kuvendi i Kosovës në mandatin e ri do të mund bashkëpunonte më mirë me shoqërinë civile si një mënyrë për të përmirësuar transparencën dhe legjitimitetin e ligjeve që po miratohen



Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka angazhuar Institutin Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim (KODI) që të realizojë një studim analitik mbi "Pjesëmarrjen e Shoqërisë Civile në Legjislacion në Nivelin e Kuvendit Qendror". Rekomandimet e dala flasin për nevojën e qartë për rritjen e nivelit të bashkëpunimit me shoqërinë civile si një mënyrë për të siguruar pjesëmarrje më të lartë qytetare. Ky studim përbëhet nga anketa me pyetësorë që është shpërndarë në mbarë Kosovën mes akterëve të shoqërisë civile, si dhe me anë të intervistave gjysmë të strukturuar me bartësit nga Kuvendi i Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile. Më poshtë është ofruar një pasqyrë e shkurtër e disa prej rekomandimeve kryesore, të cilat i janë adresuar Kuvendit të Kosovës.

Është identifikuar nevoja urgjente për të rritur sensibilizimin për shoqërinë civile si partner i qeverisë, si dhe për të përpiluar e azhurnuar një Udhëzues për zyrtarët publikë, sidomos brenda Kuvendit të Kosovës, sa i përket mënyrës së përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në procesin legjislativ në mënyrë efektive. Po ashtu në studim bëhet thirrje për krijimin e një regjistri të organizatave aktive të shoqërisë civile sipas fushës së ekspertizës, që t'u shërbejë si referencë si hartuesve në kabinet, ashtu edhe komisioneve në Kuvend. Përveç masave administrative, Kuvendi i Kosovës duhet të shqyrtojë mundësinë e futjes së një elementi mbrojtës ose klauzole interpretuese në ligj, lidhur me pjesëmarrjen e publikut, gjë që mund të bëhet përmes një deklarate të thjeshtë që e afirmon qëllimin e hartuesit që të konsultohet me publikun gjatë hartimit

të politikave publike. Ai po ashtu duhet të krijojë legjislacion specifik për të mandatuar pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e politikave publike. Ky studim e mbron qëndrimin se ligji në të cilën detajohet konsultimi qytetar ka efekt normativ pozitiv në vendim-marrjen përfshirëse, pasi që ai i standardizon procedurat dhe më shumë e kërkon sesa që e lejon konsultimin me publikun.

Një rekomandim tjetër kyç flet për hulumtimin e mundësisë së futjes në përdorim të klauzolës e "të drejtës për iniciativë" në legjislacionin përkatës. Kjo do t'i lejonte njerëzit që t'i paraqesin peticion Kuvendit për të inicuar rregullimin legjislativ të një çështje të cilën ata e konsiderojnë me rëndësi. E 'drejta për iniciativë' në përgjithësi ushtrohet përmes mbledhjes së nënshkrimeve. Për më tepër, projektlegjislacioni nuk duhet të trajtohet si konfidencial, përveç nëse nuk saktësohet nga legjislacioni përkatës. Po ashtu, Kuvendi i Kosovës duhet që në faqen e vet të internetit të publikojë agjendën legjislativë me të gjitha projektligjet e parapara për shqyrtim; përveç praktikës aktuale të publikimit të procesverbaleve të komisioneve, rretheteve të ditës dhe orarit të mbledhjeve, shënimet nga seancat e Kuvendit dhe lista e ligjeve të planifikuara që do të hyjnë në rendin e ditës, po ashtu duhet të publikohen.

Porosia themelore e këtij studimi për Kuvendin e mandatuar kohëve të fundit është se ekziston nevoja që sistemi më përfshirës i hartimit të agjendës legjislativë të transformohet në një procedurë operative standarde, pasi që kjo do të siguronte që më shumë interese, përveç atyre pak interesave të qeverisë, të përfaqësohen në dokumentin kryesor të politikave për vitin e ardhshëm legjislativ. Ai po ashtu do të ngrisë në shkallë më të lartë legjitimitetin e legjislaturës pasi që ajo do t'i tërheqte një bazë më të gjërë në shoqëri dhe do të demonstronte përgjigje e pritur që kërkohet nga zyrtarët e zgjedhur.

Teksti i plotë i këtij studimi analitik mund të gjendet në: <http://www.osce.org/kosovo/documents.html>

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka 12 anëtarë:

1. Gani Koci, kryetar, nga GP i PDK-së,
2. Haki Shatri, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDK,
3. Kosara Nikolić, zëvendëskryetar i dytë, nga GP SLS,
4. Safete Hadërgjonaj, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Hajdin Abazi, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Armend Zemaj, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Myrverte Pantina, anëtare, nga GP i LDK-së,
8. Behxhet Pacolli, anëtar, nga GP i AKR-së,
9. Xhevdet Neziraj, anëtar, nga GP i AAK-së,
10. Besa Gaxherri, anëtare, nga GP i LDD-së,
11. Müfera Şinik, anëtare, nga GP i 7+ dhe
12. Driton Tali, anëtar, nga GP i AKR-së.

2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka 13 anëtarë:

1. Bojan Stojanović, kryetar, nga GP i SLS,
2. Sanije Aliaj, zëvendëskryetare e parë, nga GP i LDK-së,
3. Müfera Şinik, zëvendëskryetare e dytë, nga komuniteti turk,
4. Zafir Berisha, anëtar nga GP i PDK-së,
5. Kosara Nikolić, anëtare nga komuniteti serb,
6. Sadik Idriz, anëtar, nga komuniteti boshnjak,
7. Numan Baliq, anëtarë, nga komuniteti boshnjak,
8. Hafize Hajdini, anëtare, nga komuniteti ashkali,
9. Hetem Arifi, anëtar, nga komuniteti ashkali,
10. Zylfi Merxha, anëtar, nga komuniteti rom,
11. Mursel Haljilj, anëtar, nga komuniteti goran,
12. Enis Kervan, anëtar, nga komuniteti turk dhe
13. Xhevdet Neziraj, nga komuniteti egjiptas.

3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka 11 anëtarë:

1. Bahri Hyseni, kryetar, nga GP i PDK-së,
2. Adem Salihaj, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDD-së,
3. Branimir Grbić, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Ramadan Gashi, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Selviqe Halimi, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Kolë Berisha, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Melihate Tërmkollli, anëtare, nga GP i LDK-së,
8. Riza Smaka, anëtar, nga GP i AKR-së,
9. Bajram Kosumi, anëtar, nga GP i AAK-së,
10. Adem Hajdaraj, anëtar, nga GP i LDK-së dhe
11. Džezair Murati, anëtar, nga GP i 7+ .

Komisionet Parlamentare të Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 31 janar 2008, ka formuar trembëdhjetë (13) komisione parlamentare, sipas emërimit dhe përbërjes në vijim:

4. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka 11 anëtarë:

1. Ismet Beqiri, kryetar, nga GP i LDK-së,
2. Hajredin Hyseni, zëvendëskryetar i parë, nga GP i PDK-së,
3. Radmila Vujović, zëvendëskryetare e dytë, nga GP i SLS-së,
4. Nerxhivane Dauti, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Naim Rrustemi, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Sanije Aliaj, anëtare, nga GP i LDK-së,
7. Luljeta Shehu, anëtare, nga GP i LDK-së,
8. Ibrahim Makolli, anëtar, nga GP i AKR-së,
9. Vezira Emruš anëtare, nga GP i AAK-së,
10. Naser Rugova, anëtar, nga GP i LDD-së dhe
11. Špresa Murati, anëtare, nga GP 7+.

5. Komisioni për Punë të Jashtme ka 11 anëtarë:

1. Sabri Hamiti, kryetar, nga GP i LDK-së,
2. Xhavit Haliti, zëvendëskryetar i parë, nga GP i PDK-së,
3. Enis Kervan, zëvendëskryetar i dytë nga GP 7+,
4. Ramë Buja, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Ramadan Avdiu, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Eqrem Kryeziu, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Lutfi Haziri, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Ibrahim Gashi, anëtar, nga GP i AKR-së,
9. Ardian Gjini, anëtar, nga GP i AAK-së,
10. Nexhat Daci anëtar, nga GP i LDD-së dhe
11. Dragiša Mirić, anëtar, nga GP i SLS-së.

6. Komisioni për Integritet Evropiane ka 11 anëtarë:

1. Zylfije Hundozi, kryetare, nga GP i AAK-së,
2. Lutfi Haziri, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDK-së,
3. Džezair Murati, zëvendëskryetar i dytë, nga GP 7+,
4. Hydajet Hyseni, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Edita Tahiri, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Sabri Hamiti, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Fatmir Rexhepi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Njomza Emini, anëtare, nga GP i AKR-së,
9. Nait Hasani, anëtare, nga GP i PDK-së,
10. Drita Maliqi, anëtare, nga GP i LDD-së dhe
11. Branislav Grbić, anëtar, nga GP SLS-së.

7. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ka 11 anëtarë:

1. Agim Velju, kryetar, nga GP i LDK-së,
2. Drita Kadriu, zëvendëskryetare e parë, nga GP i PDK-së,
3. Enis Kervan, zëvendëskryetari i dytë, nga GP 7+,

4. Memli Krasniqi, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Vlora Çitaku, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Adem Hajdari, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Fatmire Berisha, anëtare, nga GP i LDK-së,
8. Arsim Rexhepi, anëtar, nga GP i AKR-së,
9. Donika Kada-Bujupi, anëtare, nga GP i AAK-së,
10. Mark Krasniqi, anëtar, nga GP i LDD-së dhe
11. _____ anëtar, nga GP i SLS-së.

8. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka 11 anëtarë:

1. Myzejne Selmani, kryetare, nga GP i AKR-së,
2. Et'hem Çeku, zëvendëskryetar i parë nga GP i AAK-së,
3. Slobodan Petrović, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Kaqusha Jashari, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Safete Hadërgjonaj, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Haki Shatri, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Fatmir Rexhepi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Sala Berisha-Shala, anëtare, nga GP i PDK-së,
9. Zef Morina, anëtar, nga GP i LDK-së,
10. Berim Ramosaj, anëtar, nga GP i LDD-së dhe
11. Müfëra Şinik, anëtare, nga GP 7+.

9. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor ka 11 anëtarë:

1. Lulzim Zeneli, kryetar, nga GP i LDD-së,
2. Ibrahim Selmanaj, zëvendëskryetar i parë, nga GP i AAK-së,
3. Zylfi Merxha, zëvendëskryetar i dytë, nga GP 7+,
4. Berat Luzha, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Elheme Hetemi, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Ali Lajçi, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Zef Morina, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Hestet Cakolli, anëtar, nga GP i AKR-së,
9. Selvije Halimi, anëtare, nga GP i PDK-së,
10. Myrrete Pantina, anëtare, nga GP i LDK-së dhe
11. Kosara Nikolić, anëtare, nga GP i SLS-së.

10. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka 11 anëtarë:

1. Sadik Idrizi, kryetar, nga GP 7+,
2. Rita Hajzeraj, zëvendëskryetare e parë, nga GP i AKR-së,
3. Slobodan Petrović, zëvendëskryetar i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Teutë Hadri, anëtare, nga GP i PDK-së,
5. Flora Brovina, anëtare, nga GP i PDK-së,
6. Nurishahe Hulaj, anëtare, nga GP i LDK-së,

7. Bujar Bukoshi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Armend Zemaj, anëtar, nga GP i LDK-së,
9. Gjylnaze Sylja, anëtare, nga GP i AAK-së,
10. Qamile Morina anëtare, nga GP i LDD-së dhe
11. Mimoza Ahmetaj, anëtare, nga GP i PDK-së.

11. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ka 11 anëtarë:

1. Esat Brajšhori, kryetar, nga GP i AKR-së,
2. Fehmi Mujota, zëvendëskryetar i parë, nga GP i PDK-së,
3. Špresa Murati, zëvendëskryetare e dytë, nga GP 7+,
4. Gani Buçinca, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Hajdin Abazi, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Melihate Tërmkolli, anëtare, nga GP i LDK-së,
7. Ali Lajçi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Anita Morina, anëtare, nga GP i LDK-së,
9. Rasim Selmanaj, anëtar, nga GP i AAK-së,
10. Synavere Rysha, anëtare, nga GP i LDD-së,
11. Radmila Vujović, anëtare, nga GP i SLS-së.

12. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri ka 11 anëtarë:

1. Rrustem Mustafa, kryetar, nga GP i PDK-së,
2. Shkumbin Demaliaj, zëvendëskryetar i parë, nga GP i AKR-së,
3. Bojan Stojanović, zëvendëskryetari i dytë, nga GP i SLS-së,
4. Emrush Xhemajli, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Zafir Berisha, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Eqrem Kryeziu, anëtar, nga GP i LDK-së,
7. Bujar Bukoshi, anëtar, nga GP i LDK-së,
8. Agim Velju, anëtar, nga GP i LDK-së,
9. Naim Maloku, anëtar, nga GP i AAK-së,
10. Gani Geci, anëtar, nga GP i LDD-së dhe
11. Zylfi Merxha, anëtar, nga GP i 7+.

13. Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit ka 11 anëtarë:

1. Ahmet Isufi, kryetar, nga GP i AAK-së,
2. Kolë Berisha, zëvendëskryetar i parë, nga GP i LDK-së,
3. Džezair Murati, zëvendëskryetare e dytë, nga GP 7+,
4. Hydajet Hyseni-Kaloshi, anëtar, nga GP i PDK-së,
5. Fehmi Mujota, anëtar, nga GP i PDK-së,
6. Ramadan Gashi, anëtar, nga GP i PDK-së,
7. Fatmire Berisha, anëtare, nga GP i LDK-së,
8. Suzan Novobërdaliju, anëtare, nga GP i AKR-së,
9. Ismet Beqiri, anëtar, nga GP i LDK-së,
10. Besa Gaxherri, anëtare, nga GP i LDD-së dhe
11. _____ anëtar, nga GP i SLS-së.



Presidenti i Kosovës, Kryeministri, Qeveria dhe Kryetari i Kuvendit të sapo zgjedhur më 9 janar 2008

Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevoajt në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregulltë i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Hydajet Hyseni, Rasim Selmanaj, Ismet Hajrullahu, Daut Beqiri, Elli Flen, Dale Archer, Franklin De Vrieze dhe Artan Canhasi.

Redaktor: Armend Bekaj

Grafika dhe faqësja: Tomor Rudi

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
http: / /www.osce.org/ kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :
Kuvendi i Kosovës: 1, 3, 4, 12,
Hasan Sopa/OSCE: 5, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 15, 17, 20.